



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURORË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 71 DATË 02/12/2020

MBI MIRATIMIN E RREGULLAVE PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR SHKELJET QË PËRBËJNË KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET PËRKATËSE

Keshilli Bashkiak Ura Vajgurore në mbledhjen e tij të datës 02/12/2020 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Grupi i punës, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Neni 55, Urdhër Nr 633 Datë 17,11,2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, Urdhër Nr 80 Datë 17.11.2020, Neni 6 pika 1, i DAP “Departamenti i Administratës Publike” Miratimin e rregullave dhe procedurave standarte të punës të harmonizuara, gjatë peirudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19 dhe periudhës së kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021”, Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6, pika b, Vendimit nr 53 datë 24/12/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 03/08/2016 “Për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative dhe sanksionet përkatëse”, Vendimit nr 53 datë 24/12/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike”

V E N D O S I:

Me 18 vota PRO duke përdorur platformën e komunikimit **live /online Webex Meeting** (video konferencë) **të miratojë:**

1. Të miratohet Vendimi “ **Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe të dokumentacionit që do të përdoret për zbatimin e vendimit ”Për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative dhe sanksionet përkatëse**” sipas **aneksit 1, aneksit 2** dhe **aneksit 3** bashkëlidhur.
2. Të miratojë formularët për zbatimin e këtij vendimi sipas **aneksit 4** bashkëlidhur
3. Të shfuqizojë Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 03/08/2016 “Për shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative dhe sanksionet përkatëse”.

Shënim: Ky vendim u miratua me **14** vota PRO duke përdorur platformën e komunikimit **live online Webex Meeting** (video konferencë) **zoom** dhe **4** vota PRO me platformën e komunikimit online WhatsApp.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

